



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 23.2.2023

Nr: 73

Ora: 15:00

VENDIM

PËR

**LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARIT TË KZAZ NR. 69, BASHKIA POGRADEC, KZAZ NR. 63,  
BASHKIA DIMAL, KZAZ NR. 67, BASHKIA POLIÇAN, KZAZ NR. 68, BASHKIA ÇOROVODË**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenin 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, janë kërkuar zëvendësime të anëtarëve në KZAZ-të si më poshtë:

Partia Socialiste e Shqipërisë, me shkresën nr. 1069 prot., datë 23.2.2023, ka kërkuar zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr. 69, Bashkia Pogradec.

Partia Socialdemokrate, me shkresën nr. 1082 prot., datë 23.2.2023, ka kërkuar zëvendësimin e anëtarit të KZAZ nr. 63, Bashkia Dimal, anëtarit të KZAZ nr. 67, Bashkia Poliçan, anëtarit të KZAZ nr. 68, Bashkia Çorovodë.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

## V E N D O S:

1. Lirim nga detyra të anëtarëve të KZAZ nr. 69, Bashkia Pogradec, KZAZ nr. 63, Bashkia Dimal, KZAZ nr. 67, Bashkia Poliçan, KZAZ nr. 68, Bashkia Çorovodë, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Emërimin e anëtarëve të KZAZ nr. 69, Bashkia Pogradec, KZAZ nr. 63, Bashkia Dimal, KZAZ nr. 67, Bashkia Poliçan, KZAZ nr. 68, Bashkia Çorovodë, sipas lidhjes 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së si dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

**Lidhja 1**

<b>Nr</b>	<b>Qarku</b>	<b>KZAZ</b>	<b>Emri</b>	<b>Atësia</b>	<b>Mbiemri</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Pozicioni</b>
<b>1</b>	Berat	<b>63</b>	Adrian	Pëllumb	Guraj	PSD	Anëtar
<b>2</b>	Berat	<b>67</b>	Ylli	Nebi	Nurellari	PSD	Anëtar
<b>3</b>	Berat	<b>68</b>	Musa	Qamil	Shurdhi	PSD	Anëtar
<b>4</b>	Korçë	<b>69</b>	Manjola	Dhimiter	Bufi	PS	Anëtare

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



**Lidhja 2**

<b>Nr</b>	<b>Qarku</b>	<b>KZAZ</b>	<b>Emri</b>	<b>Atësia</b>	<b>Mbiemri</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Pozicioni</b>
1	Berat	<b>63</b>	Endri	Llazar	Naska	PSD	Anëtar
2	Berat	<b>67</b>	Anxhela	Barjam	Feruze	PSD	Anëtare
3	Berat	<b>68</b>	Dejvis	Tajar	Hebibasi	PSD	Anëtar
4	Korçë	<b>69</b>	Valjona	Valter	Saro	PS	Anëtare

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

